



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 616-23-429-5-2-1/C1177

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik **BESIONI SH.P.K.; N.T. FLAMURI ; Benita Company, Malisheve,** Malisheve, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë: **Rikonstruimi i rruges Ilir Konushevi dhe ndertimi i rruges Deshmoret e Ponosheci dhe Sylejman Vuciterna** me numër identifikues: 616-23-429-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Rikonstruimi i rruges Ilir Konushevi dhe ndertimi i rruges Deshmoret e Ponosheci dhe Sylejman Vuciterna**

No.	616 23 009 521
LOT 2	Ndertimi i rruges Deshmoret e Ponosheci dhe Sylejman Vuciterna

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **253,011.70 €**; [Dy qind e pesëdhjetë e tre mijë e njëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetë eurocent.],

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionat e tilla.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në kater origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin
Visar Shehu	Emri:	BASHKIM MAZREKU
Udhëheqës	Pozita:	DREJTOR
	Nënshkrimi:	
25.05.2023	Data:	25.05.2023
	Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-23-429-5-2-1/CH177

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilitdo njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesit, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5

Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6

Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund t'i japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të prilet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinga, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11

Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impianter, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuere të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12

Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohej për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatoheshin, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'i kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13

Siguria në vend-punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkojnë nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14

Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në lidhjet e komunikimit të tillë si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do t'i lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është më vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit.

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modellet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për t'i lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përparimit.

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojnë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cili dëshmohej se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtueshme Bankare.

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuarra të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30**Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**Neni 31****Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32**Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdher të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33**Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkthazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34**Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i implantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35**Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do të lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të pareaizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**Neni 36****Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpris punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Planëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi,
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-23-429-5-2-1/C1177

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës, në shënime kursive të përmendura për nëniet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës totale të kontratës në afat prej: 90 ditëve
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 ditë nga përfundimi i punëve të mëparshme.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Lot 2: 60 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 3 vite për të gjitha lotot
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendrike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 3 vite për të gjitha lotot
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për zgjidhjen

		zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	--	--

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
RIKONSTRUIMI I RRUGËS: DËSHMORËT E PONOSHECIT NË PRISHTINË, DHJETOR-2022

L=820m

Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	1.0 PUNËT PËRGADITORE DHE DEMOLIMET	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
1.1	1.1.1	Para fillimit të punimeve, në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm duhet të vendosen, të instalohen Pllaka me dimensione të përshtatshme (min 110/150 cm) me shënime apo të dhënat e projektit për sa i përket : Emrin e Autoritetit Kontraktues, Emrin e Projektit, Numrin e Lejes të Ndërtimit, Emrin e Operatorit Ekonomik, Emrin e Projektuesit dhe të dhëna të tjera me interes apo të nevojshme për projektin dhe vendin e ndërtimit, datën e fillimit të projektit dhe datën e përfundimit etj. Para fillimit të punimeve, në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm duhet të vendosen, të instalohen Pllaka me dimensione të përshtatshme (min 110/150 cm) me shënime apo të dhënat për shenjat e paralajmërimit dhe shenjat e rrezikut për vendin e ndërtimit duke specifikuar edhe masat mbrojtëse dhe paisjet e nevojshme për vendin e ndërtimit.	komplet	1	200.00	200.00
1.2	1.1.1	Kontraktori duhet të furnizoj me material pregadit dhe vendos në një vend të përshtatshëm në vend-ndërtim apo afërsi të vendit të ndërtimit, zyre të përkohshme (së paku një Kontejnerë) për nevoja të operimit dhe organizimit të punës për inxhinierin e udhëheqjes së ndërtimit apo inxhinierëve të fazave të ndërtimit si dhe për nevoja të mbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit të ndërtimit. Kontraktori duhet të furnizoj me material, pregadit dhe vendos dhoma apo ndërtime të përkohshme (apo së paku dy kontejner) zhvashtore apo garderoaba dhe dularës dhe toalete për nevoja të stafit dhe punëtorëve të kontraktorit gjatë orarit dhe tërë periudhës së ekzekutimit të punimeve.	komplet	1	2,400.00	2,400.00
1.3	1.1.2	Pikëtimi i profilin të rrugës në teren, duke vendosur hunjë të markuar me ngjyrë të kuqe për shënimin e trasesë dhe niveleve të rrugës së projektuar e cila duhet të ndërtohet sipas specifikimeve të dhëna në projektin ekzekutues.	m'	820	1.00	820.00
1.4	1.1.2	Kontraktori OE para fillimit të punimeve duhet të ofroj organit mbikqyrës një planë propozimi me shkrim, skicime dhe detale për krijimin e hapësirave për qarkullim të pa-ndërprerë të këmbësorëve dhe automjeteve gjatë kohës së zhvillimit të punimeve. Të parashihen vendet ku mund të bëhen shmanget apo devijimet apo vend-pritjet për ndërrim apo të skicohet dhe detalizohen edhe korsi paralele e përkohshme për qarkullim të pa-ndërprerë. Gjithashtu, të specifikohet apo të përkohet çartë një metodologji e organizimit dhe planifikimit si të zhvillohen punimet pa-pengesa nga komunikacioni dhe njëkohësisht të zhvillohet edhe komunikacioni i pa-ndërprerë gjatë fazës së ekzekutimit të punimeve në ndërtimin e rrugës së projektuar, duke ofruar edhe skica për mënyrën dhe zhvillimit të komunikacionit.	m'	820	2.00	1,640.00
1.5	1.1.1	Para fillimit të punimeve duhet të verifikohet, vërtetohet dhe dokumentohet se nën shtratit të rrugës ka infrastrukturë egzistuese. Kjo duhet të vërtetohet duke konsultuar paraprakisht shënime dhe të dhëna për infrastrukturën nëntokore për atë zonë nga Institucionet Relevante Komunale apo Regionale (KUR-PT-KEDS). Në rast se këto të dhëna nuk posedohen nga institucionet KUR-PT-KEDS etj, atëherë duhet të bëhet skanimi apo evidentimi i infrastrukturës nëntokore nga OE apo kontraktori. Dhe në rast të dëmtimit në çfarëdo rrethane gjatë ekzekutimit të infrastrukturës nëntokore OE mbanë përgjegjësinë dhe detyrimin që me shpenzimet e veta të bëjë të gjitha riparimet apo sanimin e dëmeve të shkaktuara nga ai vet që infrastruktura nëntokore egzistuese të jetë plotësisht funksionale sikur para fillimit të punimeve.	m'	820	1.00	820.00
1.6	1.2.2.2	Demolimi dhe transporti deri në deponi me largësi maksimale 15km i shtresave të asfaltit dhe pllakave nga betoni me dimensione trashësi t=6-8cm. Demolimi i betonit duhet të kryhet me mekanizem adekuat (Eskavator ose eskavator me çekan, ngarkues, kamion dhe paisje tjera adekuate sipas organizimeve të OE).	m²	2450	0.40	980.00
		Demolimi dhe transporti deri në deponi me largësi maksimale 15km i gurëve skajor egzistues (guret do të dërgohen në deponinë e investitorit). Demolimi i betonit duhet të kryhet me mekanizem adekuat (Eskavator ose eskavator me çekan, ngarkues, kamion dhe paisje tjera adekuate sipas organizimeve të OE).	m³	4113	0.20	822.60
1.7	1.2.2.2	Demolimi dhe transporti deri në deponi me largësi maksimale 15km i mureve nga betoni me dimensione trashësi t=(20-30)cm, lartësi h=(50-200)cm. Demolimi i betonit duhet të kryhet me mekanizem adekuat (Eskavator me çekan, ngarkues, kamion dhe paisje tjera adekuate sipas organizimeve të OE).	m³	3.5	35.00	122.50
1.8		Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit. Largimi i ujit duhet të realizohet me pompa apo nëse egziston mundësia e niveleve edhe me hapjen e kanaleve të hapura të përkohshme.	ore	1	200.00	200.00
TOTAL PUNËT E DEMOLIMIT:						8,000.10

DESIONI

Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	2.0 PUNËT E DHEUT	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
2.1	1.3	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me ngrëkim dhe bartje deri në depoti në largësi max 15km. Me thellësi maksimale 1.5m dhe gjerësi 10m. Gërmimi duhet të realizohet me eskavator dhe transporti ose largimi me kamion.	m³	4,090.00	1.50	6,135.00
2.2	1.3.4	Grryerja sipërfaqësore, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmerisë 30N/mm² (vlera minimale). Grryerja sipërfaqësore dhe planifikimi të realizohet me eskavator, greder ndërsa ngjeshja me cilindër me rrotë të lëmuar apo pneumatike duke e lagur me lagështi optimale.	m²	12,710.00	0.30	3,813.00
2.3	1.3.5	Furnizimi, transporti, punimi i bankinave me tampon 0-31.5mm me modul deformimi Mv>80MN/m².	m³	19.20	20.00	384.00
2.4	1.4.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja në shirita të rrugës në pjesën horizontale, të pjerrt dhe vertikale e gjeotekstilit me fibra sintetike të polipropilenit me jetëgjatësi min 50vjet. Rezistencë në tërheqje >20Kn/m, peshë 400gr/m², sipas standarteve EN ISO 10320 dhe EN ISO 9000. Gjeotekstili duhet të lidhet ndërmjet vetë në pikat lidhëse në min 50 njëri mbi tjetrin.	m²	4,510.00	0.60	2,706.00
2.5	1.4.2	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jo koherent (guri gëlqeror) me CBR>20%, me fraksion 0-150cm, shtrirja dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm. Kontrollat e modulit të deformimit në shtresën përfundimtare Mv>50MN/m². Gjësia e shtresave min 3m dhe maksimum 10m. Shtrirja me eskavator, ngjeshja me cilindër me rrotë të lëmuar dhe me gjemba.	m³	1,722.00	4.00	6,888.00
PUNIMET E DHEUT						13,926.00

Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	3.0 PUNËT E TAMPONIT	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
3.1	1.4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt me t=5cm (si shtres mbrojtëse e gjeotekstilit në gjendje të ngjeshur). Kjo shtresë duhet të vendoset mbasë shtrirjes së shtresave të gjeotekstilit duke e shtrirë me eskavator në mënyrë të kujdesëshme me huthje maksimale 80cm lartësi.	m³	197	12.00	2,364.00
3.2	1.4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit me Mv>80MN/m² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-63mm dhe trashësi 40cm në trup të rrugës (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e trupit të rrugës. Kjo shtresë vendoset mbi shtresën e materialit mbushës, shtrihet me eskavator, greder dhe kompaktues cilindër me vibrim.	m³	1647	5.00	8,235.00
3.3	1.4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit me Mv>100MN/m² prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31mm dhe trashësi 15cm në trup të rrugës (në gjendje të ngjeshur) si bazë për vendosjen e shtresave garkulluese të rrugës. Kjo shtresë vendoset mbi shtresën e parë të tamponit, shtrihet me eskavator, greder dhe kompaktues cilindër me vibrim.	m³	1722	8.00	13,776.00
3.4	1.4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt me t=5cm (si shtres mbajtëse e pllakave nga betoni në gjendje të ngjeshur). Kjo shtresë duhet të vendoset mbasë shtrirjes së shtresave të tamponit duke e shtrirë me eskavator.	m³	226	12.00	2,712.00
TOTAL PUNËT E TAMPONIT:						27,087.00



Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	4.0. PUNËT E BETONIT DHE ASFALTIT	Njesia	Sasia	Çmimi njesi me TVSH	Shuma totale me TVSH
4.1	800	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve të hirtë, me dimensione: 18/24 MB40 M100 në shtresë betoni MB20, duke përfshir edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngirje shkrirje.	m ¹	3385	4.00	13,540.00
4.2	800	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 8/20 MB40 M100 në shtresë betoni MB20, duke përfshir edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngirje shkrirje.	m ¹	1640	2.00	3,280.00
4.3	803	Furnizimi, transporti dhe montimi i Pllakave të betonit MB40 dhe trashësi t=100mm dy shtresore (dimenzione: 20x20 dhe 20x30) ose të ngjashme ku shtresa e parë është nga betoni i presuar ndërsa shtresa e dytë nga materialet e grimcuara si: Graniti, Kuarci, Diabazi etj me trashësi t=15mm, (trashësia në vlera referuse të standarteve evsoplan EN 13748-2. Pllaka për përdorim në hapësirë të hapura në ambient të jashtëm. Për të qen i kualifikuar si material duhet të plotësoj standartet : EC(dëklaration of conformity), Produkti të posedoj shenjen CE në përputhje me direktivat për CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 për Pllaka të ambienteve të jashtme. Montimi përfshinë edhe mbushjen e fugeve me rërë të imët si dhe ngjeshja e tyre. Ngjyra e pllakave dhe dizajni i montimit përcaktohet nga mbikqyrësi në bashkpunim me projektuesin.	m ²	3,280	5.00	15,400.00
4.4	1.4.11	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së Asfalt Binderit BA 22, BIT 50/70 me trashësi t=8,0cm si dhe sterpikjen me emulsion 0,50kg/m2 në hapsirat e shiritit të komunikacionit. Me këta parametra: Mesatarja e ngurtësimi..... N>2.2kN/mm. Mesatarja e zbrasesirave..... në kufite 3-6 %. Mesatarja e rrjedhshmerise..... r=2-4mm Mesatarja e stabilitetit..... Sl>8.0kN Kompaktesia >97% Përqindja e bitumenit për shtresën baze të asfaltit të sillel në kufite: (3.2-4.8) %	m ²	5,840	15.00	87,600.00
4.5	1.4.12	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB11, 50/70-65 me trashësi t=4,0cm si dhe sterpikjen me emulsion 0,80kg/m2 në tër hapsirën e shiritit të komunikacionit. Me këta parametra: Mesatarja e ngurtësimi..... N>2.2kN/mm. Mesatarja e zbrasesirave..... në kufite 3-6 %. Mesatarja e rrjedhshmerise..... r=2-4mm Mesatarja e stabilitetit..... Sl>8.0kN Kompaktesia >98% Përqindja e bitumenit për shtresën e Asfalt betonit të sillel në kufit: (5.4-6.4)%.	m ²	5,840	8.50	49,640.00
4.0. PUNËT E BETONIT DHE ASFALTIT						170,460.00



Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	S.O SINJALIZIMI VERTIKAL	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
5.1	4.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe me gjatësi të brinjës së trekëndëshit barabrinjës prej 900 mm,	copë	1.00	80.00	80.00
5.2	4.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjen STOP me diametër 600 mm.	copë	39.00	85.00	3,315.00
5.3	4.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 600x500mm	copë	18.00	75.00	1,350.00
5.4	4.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 300x1000mm	copë	1.00	80.00	80.00
5.5	4.5	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 500x1000mm	copë	1.00	85.00	85.00
	4.5	Verejtje: Foliet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen së paku të shkalles së dytë retro reflektuese të tipit High Intensity Grade - HIG.				
TOTALI SINJALIZIMI VERTIKAL						4,910.00


Nr. rendor	Nr sipas raportit teknik	6.0 SINJALIZIMI HORIZONTAL	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
6.1	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha të plota (gjerësia 150 mm)	m'	2,870.00	0.50	1,435.00
6.2	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha tërthore (të plota) të ndalimit (gjerësia 500 mm)	m'	40.00	0.60	24.00
6.4	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të ndërprera (1+1 m, me gjerësi 150 mm)	m'	405.00	0.60	243.00
6.5	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë për shenjimin e vendkalimit të këmbësorëve (pjesa e ngjyrosur e rrugës)	m ²	120.00	5.00	600.00
6.6	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave tërthore të bardha të ndërprera, para vendkalimit të këmbësorëve (0.5+0.5 m, me gjerësi 0.25 m)	m'	42.00	0.80	33.60
6.7	2.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë me shigjeta për lëvizje (me gjatësi 5.00 m)	copë	15.00	25.00	375.00
6.8	2.3	Verejtje: Shenjat horizontale duhet të punohen nga masat e perziera plastike dy komponenteshe të frohet me përzierje të grimeve fluoescente				
TOTALI SINJALIZIMI HORIZONTAL						2,710.60

PARAMASA DHE PARALOGARIA RIKONSTRUIMI I RRUJES: DËSHMORET E PONOSHECIT NË PRISHTINË, DHJETOR-2022		
L=820m		
1.0	PUNËT E DEMOLIMIT	8,009.10
2.0	PUNËT E DHEUT	19,926.00
3.0	PUNËT E TAMPONIT	27,087.00
4.0	PUNËT E BETON DHE ASFALTIT	170,460.00
6.0	SINJALIZIMI VERTIKAL	4,910.00
7.0	SINJALIZIMI HORIZONTAL	2,710.60
Totali:		233,202.70



PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK						
• Rr.Deshmorët e Ponoshecit						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
1	1.1	Gërmimi me dorë , makinë , çekan dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohen në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1.00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 1.7m', kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit.				
	a	gërmimi me makinë 90%	m ³	332.00	3.00	996.00
	b	gërmimi me dorë 10%	m ³	33.20	5.00	166.00
	1.2	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e ujëmbledhësve. Zgjerimi bëhet për nga 80 cm dhe thellimi për 80 cm, në dy metër gjatësi kol. 86 puseta	m ³	55	3.00	165.00
	1.3	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m ²	66	12.00	792.00
	1.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresën e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	688	1.00	688.00
	1.50	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	5	20.00	100.00
TOTAL PUNËT E DHEUT :						2,907.00

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
		2.0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
2	2.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujëmbledhësve me dim: 60*40cm.	copë	86	20.00	1,720.00
	2.2	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	a	Unaza në formë të konit	copë	10	20.00	200.00
	b	Me profil konstant	m'	12	22.00	264.00
TOTALI						2,184.00



Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Shuma totale me TVSH
		3,0 PUNËT METAL PUNUESE				
3	3.1	Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej gize DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN. pesha e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30 të parafabrikuar me dimensione të kornizës 120x120x20cm				
	a	për puseta rrugore	copë	41	120.00	4,920.00
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Llogaritja me copë.				
	a	për puseta rrugore	copë	245	1.80	441.00
	3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat (prej gize), për pesha të rënda. Në çmim të llogarohet: betonimi i kurorës prej beton armesë C-25/30.	copë	86.0	75.00	6,450.00
					TOTAL	11,811.00
		4,0 PUNËT E MONTUESE				
4	4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar dhe të kuquruar PE SN8 për kolektorë Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	a	DN- 200 mm	m'	688	4.00	2,752.00
					TOTAL	2,752.00
		5.0 TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK				
5	5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit sipas normave teknike	m'	850	0.30	255.00
					TOTAL	255.00

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK		
• Rr.Deshmoret e Ponoshecit		
1.0	PUNËT E DHEUT	2,907.00
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	2,184.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	11,811.00
4.0	PUNËT MONTUESE	2,752.00
5.0	TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK	255.00
Totali:		19,909.00



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
RIKONSTRUIMI I RRUGËS: DËSHMORËT E PONOSHECIT NË PRISHTINË, DHJETOR-2022**

1	PROJEKTI I RRUGES	233,102.70
2	KANALIZIMI ATMOSFERIK	19,909.00
3	Totali:	253,011.70 €





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **113667**

Për **KUVENDI KOMUNES SE PRISHTINES**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **BESIONI SH.P.K. & N.T."FLAMURI" & BENITA COMPANY SH.P.K**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndertimi i rruges Deshmoret e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna**
Nr. prokurimit: 616 23 009 521 , Nr. brendshëm: ...

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.
Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **25,302.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **25,302.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 180 ditë kalendarike prej **25.05.2023** deri më **21.11.2023**

Data lëshimit: 25.05.2023

Nënshkrimi dhe vija e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **113667**

Kontraktuesi	
Emri	BESIONI SH.P.K. & N.T."FLAMURI" & BENITA COMPANY SH.P.K
Përfaqësuar nga	Bashkim Mazreku
Adresa	Malishevë, Rruga Adem Jashari, pn
Nr i Biznesit	811867532
Telefoni	049302098
Përfituesi	
Emri	KUVENDI KOMUNES SE PRISHTINES
Adresa	Prishtinë
Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB
Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguarar	25,302.00
Periudha Sigurimit	25.05.2023 - 21.11.2023
Primi	455.44
Tvsh	81.98
Primi Bruto	537.41
Data e lëshimit	25.05.2023 06:59
Aktiviteti Ekonomik: Ndertimi i rruges Dëshmoret e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna	

Lënda e Garancisë
Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:
1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguararit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguararit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguararit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Luan Ramaj - 1947



Përfaqësuesi i të siguararit
Bashkim Mazreku



SIGURIMI I OBJEKTEVE NË NDËRTIM DHE MONTIM

I siguruari/ Insured:	BESIONI SH.P.K.	Numri i polices/ Policy nr:	916
Nr biznesit/ Business nr:	811867532	Ndërmjetësuesi/ Intermediary:	Luan Ramaj
Nr fiskal/ Fiscal nr:	811867532	Kodi/ Agent code:	1941
Adresa/ Address:	Rruga Adem Jashari, pn, Malishevë Malishevë Malishevë	Përfituesi/ Benefitor:	KUVENDI KOMUNES SE PRISHTINES
Telefoni/ Phone:	049302098	Adresa përfituesit/ Benefitor address:	Prishtinë
Përfaqësuesi/ Representative:	Bashkim Mazreku	Nënkontraktuesi i punimeve/ Subcontractor works:	BESIONI SH.P.K.

Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë llojë sigurimi.
 The insurance company and the policy holder vulnerably and with the good will sign this type of insurance.

Objekti i sigurimit/ Object insurance:	20,000.00	Lokacioni i rrezikut/ Risk location:	Ndërtimi i rruges Deshmoret e Ponoshecit dhe Sylejman Vuciterna
Implantet dhe pajisjet e ndërtimit/ Construction plant and equipments:	5,000.00	Numri i prokurimit/ Procurement number:	616 23 009 521
Makinertë e ndërtimit/ Construction machinery:	302.00	Data fillimit/ Begin date:	25.05.2023
Pastrimi i mbeturinave/ Waste management:	0.00	Data mbarimit/ End date:	21.11.2023
		Nr i ditëve/ Number of days:	180

Rreziqet e siguruara:

(Zjarri dhe goditja e rrufesë, eksplozimi, shtrëngata, shiu, breshëri, derdhja e ujit nga gypat, orteqet e bores, acari, pasha e borës, akulli, shembja dhe ulja e tokës, fatkeqësitë ndërtimore, pakujdesia e punëtorëve, vjedhja me thyerjaujërat nëntokësore, goditja e mjetit motorik dhe rënja e gjërave të siguruara në objektin e siguruar (plus rreziqet plotësuese)) = ALL RISK CAR/EAR.

Rreziqet plotësuese:

Vershimi dhe rrëkeja: Jo , Rrëshqitja e tokës: Jo

Përgjegjësia e kryesit të punëve ndaj palës së tretë: Jo

Përgjegjësia e kryesit të punëve ndërtimore në afatin e kontraktuar: Jo

Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së tretë për person: 50,000.00, për gjëra: 15,000.00, për përgjithshme: 65,000.00

Third part liability for insured person: 50,000.00, for things: 15,000.00, in general: 65,000.00

Shuma total e siguruar/Insured coverage: 25,302.00 €		Shuma siguruar me fjalë: njezetepesmij e treqind e dy euro e zero cent	
Neto: 80.00 €	Tvsh: 14.40 €	Bruto: 94.40 €	

Franshiza/ franchise: 10%; Franshiza në shumën minimale/ franchise at minimal value: 2,000 €

Primi paguhet menjëherë ose me këste sipas marrëveshjes së arritur mes dy palëve e cila do të jetë pjesë përbërëse e polices.
 Premium must be paid immediately or will installments according to agreement arrived between, and the agreement will be part of policy.

Sigurimi është kontraktuar sipas ofertës (pyetësorit) me shkrim të paraqitur nga i siguruari, kushteve të përgjithshme për sigurimin e pasurisë, kushteve për sigurimin e objekteve në ndërtim, kushteve të sigurimit të pajisjeve në montim dhe kushteve të sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe janë pjesë përbërëse të polices. This insurance contract is done according to general condition for property, according to CAR / EAR insurance and some supplemental risks, which are delivered to the policyholder and are policy components.

Vërejtje:

Data e lëshimit: 25.05.2023

Kompania e Sigurimeve Elsig

Luan Ramaj - 1941



I Siguruari

BESIONI SH.P.K.